ZYRA E ADMINISTRIMIT
TË BASENIT LUMOR
SHKUMBIN-SEMAN
Nr. 58/ Prot.
Date,me 04. 11. 2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI BASENIT LUMOR SEMAN**

**VENDIM**

**Nr.12, datë 30.10.2025**

**PËR**

**MIRATIMIN E KËRKESËS PËR LEJE PËR PËRDORIM BURIMI UJOR NËNTOKËSOR PËR UJË TË AMBALAZHUAR, ME VENDNDODHJE: NJËSIA ADMINISTRATIVE VERTOP, BASHKIA POLIÇAN, QARKU BERAT, TË SUBJEKTIT "SHAQO MERKAJ" P.F.**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 141, të ligjit nr.29/2024, "Për Burimet Ujore", i ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.319, datë 11.06.2025, *"Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi ujor, dokumenteve shoqëruese, procedurës së shqyrtimit e vendimmarrjes, formateve të lejes, autorizimit, kushteve të posaçme dhe afateve të vlefshmërisë së tyre"*, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Lumor Seman,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e kërkesës "Për leje për përdorim burimi ujor nëntokësor për ujë të ambalazhuar, në rastin kur përdorimi është për <= 150 shishe/orë, <= 1 l/s", të subjektit "Shaqo Merkaj" P.F, me vendndodhje: Njësia Administrative Vertop, Bashkia Poliçan, Qarku Berat.

2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

   Akuiferi: Burimi ujor i Tomorrit, Lybesh

   Vendndodhja e burimit ujor (KRGJSH):

   **X=510406.9;   Y=4503323.8;   Z=667 m.m.n.d**

Vendndodhja e pikës ku do të shfrytëzohet uji (KRGJSH):

**X=504319.2; Y=4500927; Z=188 m.m.n.d**

Sasia e ujit të kërkuar: **0.26 l/s**

Prurja mesatare vjetore: **5-8 l/s**

Qëllimi i përdorimit të burimit ujor: Për ujë të ambalazhuar

Koordinatat e pikës së shkarkimit (KRGJSH):

**X=504394.5; Y=4500789.6; Z=145 m.m.n.d**

Sasia e ujit të shkarkuar: **0.013 l/s**

Trupi ujor pritës: Lumi Vërtopit

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

**KRYETARI I KBL SEMAN**

**ANDUEL XHINDI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - KËSHILLI I BASENIT LUMOR - SEMAN